



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 27 AKTI

NR. 63 VENDIMI

Tiranë, më 06.08.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në Tiranë, më datë 3 gusht 2018, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Dollapaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Arben Dollapaj, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit ex officio.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, short nga i cili rezultoi se subjekti do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arben Dollapaj, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit, anëtarin Lulzim Hamitaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- 1. Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- 2. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4. Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹Me shkresën nr. (***) prot., datë 09.11.2017, e përbërë nga 16 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.”

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti ka pasaktësi në deklarime, ka burime të ligjshme financiare; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë; nuk është në kushtet e konfliktit të interesit..

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Nga hetimi i aftësive profesionale, pasi u hetua raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimet, subjekti i rivlerësimit u gjet “i aftë”, duke treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, dhe duke qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme”.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 26.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 26.07.2018 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 31.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 03.08.2018, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

²Me shkresën nr. (***) prot., datë 30.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Arben Dollapaj ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, është prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i pëmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, shtojca 2;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., etj.

- ç) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Pas verifikimit administrativ të kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, rezulton se:

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri:

- 1. Apartament banimi (i prindërve të mi), në qytetin e Bajram Currit, me sipërfaqe banimi 76 m².** Pronë e fituar në bazë të kontratës së privatizimit të datës 05.10.1993. Adresa: Lagjja “(***), pall. (***), hyrja (***), ap. (***), Bajram Curri. Rivlerësuar më datë 30.08.2012 për vlerën 2.211.600 lekë. Pjesë takuese 20 %.

Burimi i krijimit: Pronë e fituar në bazë të kontratës së privatizimit datë 05.10.1993, në emër të M. D., F.D., N. D., Arben Dollapit dhe Sh. D..

Hetimi i kryer nga Komisioni

Është kryer korrespondenca me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme (ZQRPP) dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajshme në rrethe. ZVRPP Tropojë³ konfirmon pasurinë nr. (***), ZK. (***), të llojit “Apartament”, me sipërfaqe 76 m², pronë e fituar në bazë të kontratës së privatizimit dhe kontratës së shitjes datë 05.10.1993, në emër të M. D., F. D., N. D., Arben Dollapit dhe Sh. D.

Arsyetimi ligjor

Privatizimi i banesave shtetërore është kryer në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.

Në nenin 1 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: *“Ky ligj ka si qëllim të realizojë privatizimin e banesave shtetërore, të krijojë tregun e lirë të banesave private..., duke u dhënë të drejtën qiramarrëseve të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre. Pronarët do të kenë të drejtë ta tjetërsojnë dhe ta hipotekojnë banesën e tyre”.*

Në nenin 20 përcaktohet se: *“Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezultoi në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992”.*

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tropojë, subjekti Arben Dollapaj, në bazë të kontratës së shitjes datë 05.10.1993, rezultoi bashkëpronar në 1/5-tën pjesë takuese.

Nuk ka dyshime mbi bashkëpronësinë dhe pjesën takuese në këtë bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

- 2. Shtëpi banimi, me sipërfaqe ndërtimi 113 m², e blerë sipas kontratës nr. (**) rep., nr. (**) kol., datë 31.03.2011.** Adresa: Njësia nr. 5, Rruga “(***), Selitë e Vogël, nr. (**), Tiranë. Vlera 9.000.000 lekë. Pjesa takuese 20 %.

³ Shiko për më tepër shkresën me nr. (**) prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tropojë dhe përgjigjen e ardhur me nr. (**) prot., datë 09.01.2018.

Burimi i të ardhurave sipas përcaktimeve në kontratën e shitjes së sipërcituar dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga subjekti.

- Kontratë shitblerjeje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.03.2011, të ½-ës së sipërfaqes së ndërtimit, prej 113 m², dhe të sipërfaqes truall, prej 157 m², në vlerë 9.000.000 lekë. Përshkrimi i objektit të shitblerjes është kati përdhe i shtëpisë dykatëshe dhe sipërfaqe truall 78.5 m². Ndodhur në ZK (***), Tiranë, dhe i regjistruar me numër pasurie (***)
- Likuidimi i vlerës prej 9.000.0000 lekë do të jetë:
 - 1.500.000 lekë në dorë (kursimet e blerësit);
 - 2.500.000 lekë është likuiduar pasi blerësi ka marrë hua;
 - Diferenca do të likuidohet me kredinë në vlerën 5.000.000 lekë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT).
- Bashkëlidhur, vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 450, datë 20.7.2004, në emër të Sh.D., për pasurinë nr. (***), ZK (***), me sip. 270 m², sip. ndërtese 113 m², lëshuar më datë 24.03.2011.
- Kërkesë për transfertë bankare me jashtë nga llogaria e subjektit, në favor të shtetasit H. S., shuma 20.000 USD, datë 30.03.2012, në “Credins Bank”. Qëllimi i transfertës: Personal debt.
- Leje legalizimi nr. (***), datë 11.07.2012, nga ALUZNI, shtesë 1 kat për banim, në objektin ekzistues 2-katësh. I jepet Arben Dollapajt dhe Sh. D. Sipërfaqe ndërtimi shtesë: 128.43 m². Numri i kateve mbi tokë 2 + 1.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë⁴, konfirmohet se në emër të Arben M. Dollapajt dhe Sh. M. D. figuron e regjistruar pasuria nr. (***) (*truall me sipërfaqe 270 m² dhe ndërtesë me sip. 118.4 m²*), vol. (***), fq. (***), e ndodhur në ZK (***), Tiranë.

Fillimisht, shtëpia e banimit dykatëshe, me sipërfaqe truall 270 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 113 m², është blerë nga Sh. D. me kontratë shitblerjeje nr. (***), datë 13.07.2004, prej shtetasit S. D.

Si burim financiar, subjekti ka deklaruar:

- a) Kursime personale të deklaruara në shumën 1.500.000 lekë.

Nga analiza financiare e vitit 2011 rezulton se subjekti ka një balancë financiare të ardhura - shpenzime pozitive e, për rrjedhojë, ai ka pasur mundësitë për të kursyer një shumë të tillë.

Viti 2011

- ✓ Me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.03.2011, të ½-ës së sipërfaqes së ndërtimit, prej 113 m², dhe të sipërfaqes truall, prej 157 m², vlera 9.000.000 lekë, subjekti ka blerë shtëpi banimi, katin përdhe të shtëpisë dykatëshe të vëllait të tij Sh.

⁴ Shiko në dosje shkresën me nr. (***) prot., datë 04.01.2018, dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***)prot., datë 26.01.2018, nga kjo zyrë.

D., i cili me kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 13.07.2004, ka blerë pronën me sipërfaqe trualli 270 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 113 m², me shitës shtetasin S. D.

Burimi i të ardhurave për likuidimin e vlerës së shtëpisë së blerë:

- kredi në Bankën Kombëtare Tregtare, më datë 18.05.2011, në shumën prej 5.000.000 lekësh;
 - marrë borxhe në vitin 2010 në shumën 25.000 USD (*ose, të konvertuar me 104.95 lekë/USD sipas kursit të këmbimit mesatar të marrë nga BSH për vitin 2010, shuma 2.623.750 lekë*); dhe
 - nga kursimet *cash*: 1.500.000 lekë.
- ✓ Sipas kontratës së shitblerjes, znj. F. D., nëna e Sh., N. dhe Arben Dollapajt, është pronare e vetme e sipërfaqes 258 m², mbi të cilën është ndërtuar një shtëpi banimi, ndodhur në fshatin Valbonë, e padeklaruar në vitin 2007. Në Hipotekë figuron e regjistruar në emër të nënës dhe nuk është e deklaruar në vitin 2007, por është deklaruar në deklaratën “Vetting”. Në vitin 2011 është blerë truall shtesë për mensë kuzhine në shtëpinë e ndodhur në Valbonë, Tropojë, në emër të nënës së subjektit, me vlerë 324.065 lekë.

ANALIZA FINANCIARE		Viti 2011
1	Të ardhurat	2.843.788
	- Paga e subjektit	2.131.060
	- Paga e bashkëshortes	556.068
	- Pensioni i nënës	156.660
2	Pasuritë	6.211.019
	- Blerë truall shtesë për mensë kuzhine, Valbonë, Tropojë	324.065
	- Pakësuar likuiditetet <i>cash</i> në shtëpi	- 3.113.046
	- Shtëpi banimi me sip.113 m ² , ½ pjesë e shtëpisë së vëllait	9.000.000
3	Detyrimet	4.783.922
	- Kredi në “BKT” 18.05.2011	5.000.000
	- Shlyer kredia konsumatore	- 56.000
	- Shlyer këst kredie në “BKT”	-160.078
5	Shpenzimet	1.036.632
	- Për shkollimin e djalit shkolla "(***)"	80.000
	- Shpenzime jetike	785.714
	- Interesi për kredinë në BKT	115.918
	- Shpenzime sipas TMS	55.000
6	Diferenca	380.059

Viti 2011

- b) Hua nga kunati i tij, z. H. S., në vlerën prej 25.000 USD (*të deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2010*) transferuar kjo shumë nga SHBA-të në datën 29.04.2010 në “Credins Bank” në nr. e llogarisë së subjektit, për blerjen e gjysmës së shtëpisë së të vëllait nga ana e subjektit.

Nga verifikimet e kryera konfirmohet transferta bankare e sipërcituar dhe, duke qenë se ajo është kryer nga një institucion bankar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, trupi gjykues e ka vlerësuar si të panevojshëm verifikimin e mëtejshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj shume, pasi e konsideron këtë proces si të kryer nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës qysh në momentin e depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare të huadhënësit.

Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit, u bënë verifikime online në lidhje me shoqërinë “(***) S. 45th Street (***)” Philadelphia, të referuar nga subjekti i rivlerësimit në sqarimet e dhëna prej tij pranë ILDKPKI-së në datën 18.01.2016, nga ku u konfirmua ekzistenca e kësaj shoqërie, si dhe marrëdhëniet e interesit ekonomik të z. H. S. në shoqëri të ndryshme, si: “(***) LLC”, “(***) LLC”, “(***) Associates”, çka dëshmon për një situatë të mirë ekonomike të huadhënësit.

c) Kredi në “BKT” më datë 18.05.2011 në shumën 5.000.000 lekë, nga e cila deri në deklaratën “Vetting” ka mbetur e pashlyer shuma prej 3.504.087 lekësh.

➤ Në vitin 2012 është dhënë leje legalizimi, nr. (***), datë 11.07.2012, për shtesë 1 kat në objektin ekzistues 2-katësh, në emër të Arben dhe Sh. Dollapajt. Sipërfaqja e shtesës: 128.43 m². Regjistruar në ZVRPP më datë 30.07.2012, referuar dokumentit nr. (***)

Nga korrespondenca e kryer me zyrën e ALUIZNI-t⁵ Tiranë, konfirmohet se subjekti Arben Dollapaj dhe Sh. D. janë pajisur me leje legalizimi nr. (***), datë 11.07.2012, shtesë 1 kat për banim në objektin ekzistues 2-katësh, sipërfaqe banimi 128.43 m², Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë. Numri i kateve mbi tokë 2+1. Sipas formularit të pagesës, bashkëlidhur praktikës së legalizimit, vlera e investimit është 3.638.807 lekë. Pjesë e dosjes është gjithashtu edhe një deklaratë noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 14.11.2006, ku z. Sh. D. deklaroi se: “*Jam pronar i një shtëpie banimi 2- katëshe, e ndodhur në Rr. ‘(***)’, Tiranë, me sipërfaqe ndërtese 113 m² dhe sipërfaqe trualli 270 m². Meqenëse nëna ime F. D. dhe vëllai im Arben Dollapaj janë të pastrehë, u jap leje dhe jam dakord që të ndërtojnë katin e tretë të kësaj shtëpie në pronësinë time. Kati i tretë që do të ndërtohet do të jetë me sipërfaqe 113 m², do të jetë ambient banimi dhe në bashkëpronësi të nënës sime, F. dhe vëllait tim, Arben Dollapaj*”.

Trupit gjykues, pasi shqyrtoi deklaratat periodike të subjektit në vite për periudhën 2003 - 2016, si dhe deklaratën “Vetting”, - si dhe nga analiza financiare tabelare e viteve 2006 dhe 2007, periudhë kohore në të cilën është ndërtuar dhe përfunduar shtesa dhe efekti financiar në lidhje me të, si më poshtë:

Viti 2006

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2006
1	Të ardhurat	1.652.139
	- Paga e subjektit	819.275
	- Paga e bashkëshortes	318.076
	- Pensioni i nënës	104.100
	- Pjesëmarrja në Këshillin e Prokurorisë	36.000
	- Dhuratë nga motra 4.000 USD, të konvertuar në lekë me kursin mesatar vjetor nga BSH	374.688
2	Pasuritë	898.456
	- Kursime <i>cash</i> në shtëpi	750.000

⁵ Shiko për më tepër shkresën në dosje me nr. (***) prot.datë 04.01.2018 drejtuar Aluiznit Tiranë.

	- Shtuar gjendja në llog. bankare	148.456
3	Detyrimet	0
4	Shpenzimet	789.714
	- Shpenzime jetike	785.714
	- Shpenzime për udhëtimet jashtë vendit (TIMS)	4.000
	Diferenca	- 36.031

Viti 2007

	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2007
1	Të ardhurat	1.625.115
	- Paga e subjektit	900.687
	- Paga e bashkëshortes	353.088
	- Pensioni i nënës	122.250
	- Dhurate nga motrat	249.090
2	Pasuritë	678.604
	- Shtesë kati me sip. 113 m ² në banesën e vëllait	1.700.000
	- Pakësuar likuiditetet <i>cash</i> në shtëpi	-1.021.396
3	Detyrimet	-
5	Shpenzimet	909.714
	- Për shkollimin e djalit shk. "(***)"	64.000
	- Shpenzime jetike	785.714
	- Për udhëtimet jashtë vendit	60.000
6	Diferenca	36.797

- i rezulton se subjekti, pavarësisht një balance financiare, shpenzime-të ardhura, negative për vitin 2006, në shumën 36.031 lekë, ka pasur burime financiare të ligjshme mjetet e duhura monetare për kryerjen e këtij investimi.

Shtesa e katit nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, por ajo është deklaruar për herë të parë në Deklaratën e Interesave Private Periodik/Vjetor të vitit 2007 me përshkrimin: “Një shtesë kati me sipërfaqe 113 m², në banesën e vëllait tim Sh. D. Banesa është e papërfunduar dhe është deklaruar për legalizim më datë 01.11.2006. Vlera: 1.700.000 lekë”.

Në këtë mënyrë, subjekti nuk ka përmbushur një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 3, pika 11, dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, duke e bërë deklarin të pasaktë.

Për të arritur në një konkluzion të saktë në lidhje me shkakun e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, mundësinë e fshehjes së kësaj pasurie, aftësinë financiare të subjektit për ndërtimin e shtesës së katit, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti.

- Komisioni ka pyetur subjektin për të saktësuar vitin e ndërtimit të shtesës së katit, sepse ajo është deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2007, si e ndërtuar mbi banesën dykatëshe të vëllait, me vlerë 1.700.000 lekë, kurse nga dokumentet e

vetëdeklarimit për legalizim të shtesës së katit, rezulton se ky aplikim është bërë më 01.11.2006.

Subjekti sqaron se: *“Shtesa e katit ka filluar në korrik të 2006-ës dhe ka përfunduar në shkurt të 2007-ës. Për arsye se likuidimi i shumës është bërë kur kanë përfunduar punimet në vitin 2007, është pasqyruar në deklaratën e pasurisë 2007, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe efekti financiar”.*

- Subjekti është pyetur: *“Cila është arsyeja e mosdeklarimit të shtesës së katit dhe vlerës së investimit në deklaratën ‘Vetting’?”.*

Subjekti sqaron se: *“Shtesa e katit është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2007. Po ashtu, edhe kontrata e shitblerjes me nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 31.03.2011, është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2011 dhe, duke qenë se bëhet fjalë për një objekt ku jemi bashkëpronarë unë dhe vëllai, vlerësoj se është e pasqyruar edhe shtesa e katit. Shtesa e katit posedohet nga vëllai dhe kalimi përfundimtar i pronësisë në emër të vëllait nuk mund të bëhet, sepse është vënë garanci bankare”.*

Në shpjegimet e dërguara nga subjekti në lidhje me rezultatet e hetimit, në datën 29.07.2018, ai sqaron se: *“Vëllai im, Sh.D., ka qenë pronar i një banese private me 2 kate, në rrugën “(***)”, nr(***) Selitë e Vogël, Tiranë. Pasi ai kishte marrë një leje për rikonstruksion (të çatisë dhe të tavaneve), me dakordësinë e tij, unë kam bërë një shtesë kati me sipërfaqe 113 m². Shtesa e katit ka filluar në korrik të vitit 2006 dhe ka përfunduar në shkurt të vitit 2007. Gjatë kësaj periudhe janë kryer punimet e vrazhda, si muret rrethuese, çatia dhe muret ndarëse.*

*Meqënëse vëllai im jetonte vetëm me bashkëshorten e tij në shtëpi, i kam propozuar që t'i blija një pjesë të shtëpisë së banimit, pasi unë e kisha të nevojshme një sipërfaqe banimi më të madhe. Vëllai im ka rënë dakord, por me kushtin që ai të jetonte në katin e tretë (shtesë e katit të papërfunduar) dhe une të merrja katin e parë dhe katin e dytë, si dhe t'i jepja plus shumën prej 9.000.000 lekësh për marrjen e sipërfaqes shtesë të banimit. Ky shkëmbim nuk mund të pasqyrohej në kontratën e shitjes nr. (***), datë 31.03.2011, pasi nuk ishte kryer akoma formalizimi i shtesës së katit (është kryer në prill të vitit 2012) dhe praktikisht e bënte të paregjistrueshme kontratën e shitjes pranë ZVRP-së Tiranë. Në këto kushte është pasqyruar vetëm shitja e pjesëshme e shtëpisë, por në aspektin formal ne jemi bashkëpronarë. Kjo konfirmohet edhe nga vërtetimi hipotekor nr. (***), datë 07.04.2011, dhe vërtetimi hipotekor nr. 849, datë 30.07.2012, ku rezultojmë bashkëpronarë formalisht me pjesë ½ secili”.*

Në shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore, subjekti sqaron se: *“Ashtu sikurse është deklaruar edhe nga ana juaj, janë deklarime të bëra në vitin 2007, 2011, në deklaratat e viteve përkatëse, që është deklaruar jo vetëm shtesa e katit, por edhe kontrata që unë kam nënshkruar. Gjithë kjo pasaktësi ka ardhur për faktin që nga ana ime dhe e vëllait nuk është bërë, nuk është pasqyruar dhe realizuar pjesëtimi i pasurisë. Kjo ka ardhur për faktin se pjesa takuese që kam unë është si garanci bankare për kredinë që kam marrë dhe për të bërë një pjesëtim pasurie, duhej që me miratimin e bankës të bëhej rivlerësimi i pasurisë, duhej të kalonte në bordin e bankës, të bëhej një kontrate tjetër me bankën për vendosjen e një garancie për pjesën e sipërfaqes takuese timen dhe vëllai im të çlirohej nga pjesa e barrës së garancisë në sipërfaqen e tij të banimit, duhej të bëhej në regjistrimin pranë ZVRRPP-së Tiranë. Kjo procedurë nuk është bërë për dy elemente, për elementet burokratike dhe elementet e shpenzimit, sepse kanë një kosto jo të vogël. Megjithatë, qoftë dhe për shkak të këtij procesi, duhet të bëhej nga ana ime pjesëtimi i pasurisë.*

*Janë të drejta këto konstatime, por ngushëllohem me faktin që nuk ka fshehje të pasurisë. Vlerësoj që nuk ka deklarim të pasaktë, duke pasur parasysh që në deklarimin e rivlerësimit në vitin 2017, kam pasqyruar vetëm pjesën takuese që kam unë në zotërim. Kjo është lehtësisht e verifikueshme edhe fizikisht. Unë banoj në atë pjesë që kam deklaruar, ndërsa vëllai im në hyrje të veçantë, banon në pjesën e shtesës të katit. Duke pasur parasysh që edhe në vërtetimin që unë i kam bashkëlidhur, jo vetëm deklaratës në vitin 2007 dhe 2011, por edhe deklaratës “Vetting”, pra për shkak të procesit të rivlerësimit, - unë i kam bashkëlidhur dy vërtetimet hipotekore që janë cituar nga ana ime. Pra, është vërtetimi hipotekor nr. (***) , datë 07.04.2011, dhe vërtetimi nr. (***) , datë 30.07.2011, ku përshkruhen pjesët takuese. Kështu që, vlerësoj se duhet të ishte bërë kjo pjesë edhe nga ana ime për qartësimin e këtyre elementeve formale”.*

Arsyetimi ligjor

- ✓ Subjekti ka deklaruar burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për blerjen sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 31.03.2011, të ½-ës së sipërfaqes së ndërtimit, prej 113 m², dhe të sipërfaqes truall, prej 157 m², në vlerë 9.000.000 lekë, konkretisht kati përdhe i shtëpisë dykatëshe dhe sipërfaqe trualli 78.5 m².
- ✓ Në deklaratën “Vetting” është deklaruar shtëpia e banimit me sipërfaqe ndërtimi 113 m² sipas kontratës nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 31.03.2011, për çmimin 9.000.000 lekë. Shtesa e katit në objektin ekzistues nuk është deklaruar, por në dokumentacionin që ka depozituar subjekti në ILDKPKI, që shoqëron deklaratën “Vetting”, rezulton e dorëzuar leje legalizimi nr. (***) , datë 11.7.2012, çka do të thotë se subjekti e konsideron shtesën e katit si të përfshirë në deklarim në deklaratën “Vetting”, si pjesë përbërëse të shtëpisë së banimit, sikurse e ka deklaruar në përgjigje të pyetësorëve.
- ✓ Mosdeklarimi nga ana e subjektit të shtesës së katit në deklaratën “Vetting” nuk përbën fshehje pasurie sipas parashikimeve në nenin 33, pika 5/c, të ligjit nr. 84/2016, sepse:
 - i. subjekti nuk e ka fshehur ekzistencën e shtesës së katit ndër vite, duke e deklaruar atë në deklaratat periodike të pasurisë;
 - ii. mosdeklarimi i shtesës në deklaratën “Vetting”, duke marrë në konsideratë edhe sqarimet e subjektit, është më së shumti një konfuzion i tij në deklarim, duke e konsideruar shtesën e katit si të deklaruar së bashku me shtëpinë e banimit ku ai dhe vëllai i tij, Sh.D., janë bashkëpronarë;
 - iii. subjekti deklaron se në shtesën e katit nuk banon ai, por vëllai i tij. Ky fakt konfirmohet edhe nga deklaratimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI më datë 18.01.2016, deklarim i përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision me shkresën nr. (***)prot., datë 11.07.2018.
 - iv. duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme si adresë banimi pikërisht adresën e vendndodhjes së shtëpisë së banimit ku ai rezulton bashkëpronar me të vëllain, Shkëlzen Dollapaj, në ½ pjesë, si dhe faktin që shtesa e katit të tretë është pjesë përbërëse e së njëjtës godinë (në përdorim të vëllait të subjektit sipas sqarimeve të tij), trupi gjykues vlerëson se nuk kemi të bëjmë me fshehje pasurie, por me një deklarim të pasaktë të sipërfaqes së pjesës takuese në pronësi subjektit në godinën trekatëshe.

- ✓ Subjekti disponon mjete të mjaftueshme financiare për ndërtimin e shtesës në katin e tretë në shumën prej 1.700.000 lekësh.
- ✓ **Shtesa e katit të tretë në shtëpinë e banimit ekzistuese 2-katëshe është e legalizuar** në bazë të lejes së legalizimit nr. (***) , datë 11.07.2012, në emër të subjektit Arben Dollapaj dhe vëllait të tij, z. Sh. D. Ky i fundit (Sh. D.) është pronar i truallit dhe i shtëpisë së banimit me të dhënat e mësipërme, çka do të thotë se shtesa e katit të tretë është e ndërtuar në truall privat. Ndërtimi pa leje i katit të tretë shtesë, i kryer nga subjekti mbi shtëpinë e banimit në pronësi të vëllait të tij, z. Sh. D., përveçse një domosdoshmëri për sigurimin sa më shpejt të një ambienti për jetesë për subjektin dhe familjen e tij, mund të konsiderohet edhe pasojë e mosveprimit në kohë të organeve kompetente shtetërore, për pajisjen e shtetasve me leje ndërtimi/zhvillimore përkatëse.
- ✓ Ndërtimet pa leje janë parashikuar fillimisht në ligjin nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën” si kundërvajtje administrative. duke u sanksionuar dhe dënimi me gjobë. Në ligjin nr. 8405. datë 17.09.1998. “Për urbanistikën”, përsëri është vijuar me të njëjtin qëndrim të ligjvënësit, por për herë të parë u parashikua legalizimi i ndërtimeve pa leje, kryesisht i ndërtimeve të kryera pa leje nga pronarët në pronat e tyre, ku sipas nenit 77, KRRT-ja duhej të vendoste legalizimin e ndërtimit, me kushtin e shlyerjes së detyrimit nga ndërtuesi.

Në Kodin Penal, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, në seksionin XI, janë parashikuar veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës si “shpërdorimi i tokës” dhe “pushtimi i tokës”, por akoma nuk kishte një parashikim të ndërtimit të paligjshëm si vepër penale.

Duke marrë shkas nga numri shumë i madh i ndërtimeve të paligjshme, të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe në mënyrë të pakontrolluar nga shteti, situatë që po cenonte në mënyrë të pariparueshme zhvillimin e territorit, në vitin 2008 u miratuan ndryshimet në Kodin Penal, ku ndërtimi pa leje u konsiderua për herë të parë si vepër penale më vete. Konkretisht, në ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, në nenin 199/a, parashikohet se: *“Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”*.

Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje u formalizua me qëllim ndalimin e këtij fenomeni, integrimin e këtyre ndërtimeve informale, për aq sa ishte e lejuar, në zhvillimin urban të vendit, por edhe në qarkullimin civil, duke u miratuar një paketë e plotë ligjore që u finalizua me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Sa më sipër, ndërtimi pa leje i katit të tretë nga subjekti mbi ndërtesë ekzistuese të ndërtuar mbi truall në pronësi private, është parashikuar si kundërvajtje administrative në bazë të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën” dhe nuk përbën vepër penale në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e ndërtimit.
- ✓ Procesi i rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazohet jo vetëm në detyrimin formal të subjekteve për të deklaruar me vërtetësi dhe saktësi të dhëna në lidhje me tri kriteret e parashikuara nga ligji, por edhe në qëndrimin që ata mbajnë në raport me gjithë procesin e rivlerësimit, ku subjekti duhet të reflektojë integritet, si dhe të dëshmojë me vërtetësi dhe transparencë në çdo deklaram, në funksion të forcimit të

besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, qëndrim i cili është konstatuar në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.

- ✓ Trupi gjykues çmon se veprimet apo mosveprimet e subjektit, si më sipër (i, ii, iii, iv) referuar, nuk mund të konsiderohen sjellje aktive, me qëllim fshehje të pasurisë, e për pasojë për të mbuluar/fshehur burimin e ligjshëm të krijimit, vendndodhjen, ose lëvizjen e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre.
- ✓ Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka dhënë deklaratime të mjaftueshme, të cilat në ballafaqim edhe me provat e disponuara nga Komisioni, të çojnë në konkluzionin se në lidhje me mosdeklarimin e shtesës së katit në deklaratën “Vetting”, nuk kemi të bëjmë me fshehje pasurie, mungesë burimesh financiare të ligjshme apo deklarim të rremë, por me një pasaktësi në deklarim e, për rrjedhojë, nuk mund të konkludohet se kemi të bëjmë me shkelje të ligjit që mund të çojë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.

3. Shtëpi banimi në fshatin Valbonë, Tropojë, sipas kontratës aktmarrëveshje për bashkinvestim (për rikonstruksionin) dhe bashkëpronësi, nr. (*) rep., nr. (***) kol., datë 28.01.2013.** Nuk kanë përfunduar akoma punimet. Vlera 5.000.000 lekë (jo përfundimtare). Nuk janë specifikuar përqindjet.

Burimi i krijimit. Aktmarrëveshje për bashkinvestim dhe bashkëpronësi, nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 28.01.2013.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Shtëpia e banimit në fshatin Valbonë, Tropojë, është deklaruar në deklaratën “Vetting” edhe nga personi i lidhur me subjektin/nëna e tij, znj. F. D., e cila deklaron: *“Një shtëpi banimi në fshatin Valbonë, Tropojë, sipas kontratës nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.03.2007; kontratës nr. (***)rep., e nr. (***) kol., datë 07.11.2008; kontratës nr. (***) rep., e nr. (***) kol., datë 27.04.2011. Vlera: 700.000 lekë. Pjesa në përqindje: 100 %”.*

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, analiza e provave të administruara, deklaratimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti, rezultoi se:

Sipas kontratave të shitblerjes, znj. F. D., nëna e subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, është pronare e vetme e sipërfaqes 258 m², mbi të cilën është ndërtuar një shtëpi banimi, ndodhur në fshatin Valbonë, Tropojë, ZK (***) , me nr. pasurie (***) dhe nr. (***) . Për arsye amortizimi është nënshkruar aktmarrëveshja për bashkinvestim, në mënyrë të barabartë ndërmjet saj dhe tre fëmijëve të saj, Sh., N. dhe Arben Dollapaj dhe bashkëpronësi me ¼-tën pjesë secili. Bashkëlidhur vërtetim hipotekor nr. (***) , datë 23.1.2008, dhe nr. (***) , datë 23.06.2011, në emër të F. D.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tropojë rezulton se në emër të F. R.D., e ëma, person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, e cila rezulton e regjistruar në një certifikatë familjare me subjektin, janë të regjistruara këto pasuri:

- ✓ Pasuria nr. (***) , ZK (***) , Valbonë, vol. (***) , fq. 3, njësi me sipërfaqe 88 m², në emër të F. D., person i lidhur me subjektin e rivlerësimit⁶, blerë nga personi i lidhur me

⁶Shiko për më tepër shkresën me nr. (***) prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tropojë dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***)prot., datë 09.01.2018, me të cilën figurojnë pasuri në emër të F.R. D.fitur me kontratë shitblerjeje me DASHPP.

kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.03.2007, prej shitësit T.M. kundrejt çmimit 700.000 lekë.

- ✓ Pasuria nr. (***) , ZK (***) , Valbonë, vol. (***) , fq. (***) , truall me sipërfaqe 88 m², blerë nga personi i lidhur, F. D., me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.11.2008, prej shitësit Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Tiranë kundrejt çmimit 145.552 lekë.
- ✓ Pasuria nr. (***) , ZK (***) , Valbonë, vol. (***) , fq. 7, truall me sipërfaqe 197 m², blerë nga personi i lidhur, F. D., me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.04.2011, prej shitësit Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Tiranë kundrejt çmimit 324.065 lekë.

Nga korrespondenca e kryer me ILDKPKI-në, me shkresën nr. (***)prot., datë 11.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në këtë institucion, veç të tjerash: leje zhvillimi datë 05.03.2013, leje ndërtimi datë 05.03.2013, preventiv, grafik punimesh dhe ndikim i zhvillimit në infrastrukturë dhe shërbimeve të zonës ku propozohet të kryhen punimet.

U konstatua se personi i lidhur me subjektin, znj. F. D. nëna e subjektit të rivlerësimit:

1. Në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shtëpinë e banimit në fshatin Valbonë, Tropojë, si dhe tri kontratat e shitblerjes së kësaj pasurie, por ka deklaruar si vlerë vetëm atë të blerjes së kontratës së parë prej 700.000 lekësh, por nuk ka deklaruar dy vlerat e tjera të blerjes së dy trojeve, përkatësisht 145.552 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 07.11.2008 dhe 324.065 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.04.2011;
2. Nuk ka deklaruar burimin e financimit për blerjen e pasurisë nga e ëma në vitet 2007, 2008, 2011 si person i lidhur, në vlerat: 700.000 lekë; 145.552 lekë dhe 324.065 lekë.

Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka dërguar shpjegimet dhe provat si më poshtë:

- Në lidhje me konstatimin e parë, subjekti sqaron se: *”Ekziston pasaktësia për sa i përket mosparaqitjes së vlerave të dy kontratave të shitjes së truallit. Është deklaruar vlera e objektit, por jo vlera totale e objektit bashkë me sipërfaqen truall dhe sipërfaqen funksionale. Ka ardhur thjesht si një perceptim i vlerës së objektit. Nuk ka qëllim për të fshehur apo për të mos dhënë informacion. Janë cituar dy kontratat e blerjes së truallit dhe kontratat i janë bashkëlidhur deklaratës”.*

- *“Në lidhje me blerjen e shtëpisë në fshatin Valbonë, Tropojë, unë nuk kam kontribuar financiarisht. Do të dëshiroja këtu të bëja një ndërhyrje të vogël, pavarësisht se kjo nuk përbën provë. Në këtë dëshirë të nënës sime për të pasur edhe ajo shtëpi në vendin e lindjes, ashtu si vëllezërit e saj, është përkrahur nga vëllai im dhe motra ime.*

Nëna ime, në blerjen e shtëpisë, është ndihmuar nga vëllai im. Fillimisht vëllai, në muajin nëntor 2006, i ka dhënë një kapar prej 2.500 eurosh (e konfirmuar nga dokumenti bankar i Intesa Sanpaolo Bank) pronarit të shtëpisë, z. T. M. (shtëpi të cilën e kishte fituar nga privatizimi si ish-punonjës i Ndërmarrjes Gjeologjike). Kjo shumë është paguar që ai të bënte dokumentacionin e tokës, pasi në ZVRPP Tropojë trualli i shtëpisë dhe sipërfaqja funksionale rezulton si tokë shtetërore.

Në muajin janar 2007, vëllai i ka dhënë edhe një kapar tjetër prej 4000 eurosh (e konfirmuar nga dokumenti bankar i Intesa Sanpaolo Bank) dhe në muajin mars të vitit 2007 është lidhur

kontrata nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.03.2007, (në vlerën 700.000 lekë) vetëm për shtëpinë, pasi ish-pronari nuk arriti të bënte dokumentacionin në lidhje me blerjen e tokës truall nga shteti. Mënyra e pagesë së kësaj shume deklarohet edhe në këtë kontratë, ku thuhet shprehimisht për shumën se 'palët deklarojnë se e kanë likuiduar totalisht para përpilimit të kësaj kontrate dhe jashtë kësaj zyre'.

Edhe blerja e sipërfaqes truall (88 m²) nga shteti (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), për të cilën është lidhur kontrata nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 07.11.2008, pagesa prej 145.552 lekësh është bërë nga ana e vëllait tim. Në mandatin e pagesës së "Raiffeisen Bank", ku është bërë derdhja e pagesës në funksion të kontratës, te klienti është shënuar emri i F. D., por është firma e vëllait tim, kjo është lehtësisht e konstatueshme dhe që konfirmon që shuma është paguar nga ai.

Ndërsa në blerjen e sipërfaqes funksionale (197m²) nga shteti (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), për të cilën është lidhur kontrata nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 27.04.2011, në vlerën 324.065 lekë, nëna ka autorizuar vëllain tim, me prokurën nr. 840 rep., nr. (***) kol., datë 22 prill 2011, për të lidhur kontratën dhe për të bërë pagesat e nevojshme, si dhe për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e pronës.

Përveç këtyre pagesave, vëllai im ka bërë edhe pagesa të tjera, si pagesa e tarifave administrative pranë komunës Margegaj, Tropojë, në datën 04.12.2013, e dokumentuar kjo me dokumentin "Derdhje për thesarin".

Nëna ime dhe vëllai im kanë deklaruar secili, nëpërmjet deklaratave noteriale, ku konfirmojnë se pagesat e kryera për të tria kontratat e më tej janë kryer nga vëllai im, Sh.D. Kontributi i tij do të pasqyrohet në pjesëtimin e pasurisë në momentin e përfundimit të të gjitha punimeve dhe regjistrimit të kësaj pasurie.

Shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit janë të shoqëruara me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Bilancin e llogarisë pranë "Intesa Sanpaolo Bank" të z. Sh. D., datë 27.01.2012, ku pasqyrohet balanca prej 6.719,57 eurosh më datë 01.11.2006 dhe dy debitime të saj, përkatësisht në datën 01.11.2006 për shumën 2.500 euro dhe më datë 29.01.2007 në shumën 4.000 euro, çka konfirmon se pagesat për blerjen e objektit në Valbonë, Tropojë, në vitin 2007, janë kryer nga z. Sh. D.
- b) Kontrata nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.03.2007, për vlerën 700.000 lekë.
- c) Dokumenti veprim arke pranë "Raiffeisen Bank", derdhje *cash* 145.552 lekë.
- ç) Prokura e posaçme e F.D., nr. (***) rep, nr. (***)kol., datë 22 prill 2011, ku autorizon djalin e saj, Sh. D., ndër të tjera edhe për kryerjen e pagesës për blerjen e sipërfaqes së truallit funksional prej 197 m² dhe lidhjen e kontratës së shitblerjes me Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Tiranë.
- d) Pagesa në "Intesa Sanpaolo Bank" për shumën 324.552 lekë.
- dh) Dokument arke "Derdhje për thesarin", komuna Margegaj, pranë "Raiffeisen Bank", i datës 04.12.2013, konfirmohet derdhja nga ana e z. Sh. D. e një tarife prej 61.919 lekësh si tarifë administrimi.
- d) Deklaratë noteriale e z. Sh. D. nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 10.07.2018, e cila konfirmon gjithashtu se të gjitha pagesat për blerjen e objektit në Valbonë, Tropojë, janë kryer nga ana e tij për llogari të nënës, madje për blerjen e truallit funksional në vitin 2011 ka pasur edhe prokurë të posaçme.
- e) Deklaratë noteriale nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 27.07.2018, e personit të lidhur, znj. F. D., e cila deklaron se të gjitha pagesat për blerjen e objektit në Valbonë janë kryer nga djali i saj, Sh.D., me kërkesë dhe për llogari të saj.

Nga analiza financiare e viteve 2014 dhe 2016, kur subjekti ka investuar në objektin e ndodhur në Valbonë, Tropojë, sipas kontratës së bashkëinvestimit në bashkëpronësi me nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 28.01.2013, e pasqyruar si më poshtë:

Vitet 2014, 2015 dhe 2016

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1	Të ardhurat	2.476.780	2.452.660	2.531.752
	- Paga e subjektit	1.685.490	1.511.538	1.755.420
	- Paga e bashkëshortes	620.002	703.974	717.789
	- Pensioni i nënës	171.288	173.828	58.543
	- Dhuratë nga vajza e motrës		63.320	
2	Ndryshimi i pasurisë	1.800.000	-1.744.394	3.250.000
	- Shtuar/Pakësuar likuiditetet <i>cash</i>	200.000	-1.744.394	-250.000
	- Rikonstruksioni i shtëpisë në Valbonë, sip. 88 m ²	1.600.000		3,500,000
3	Detyrimet	875.271	-1.408.162	2.277.502
	Shlyerje e kredisë (principal) "BKT"	-274.729	-258.162	-272.498
	Për rikonstruksionin e shtëpisë në Valbonë	1.600.000		3.500.000
	Shlyerje detyrimi për rikonstruksionin e shtëpisë në Valbonë	-450.000	-1.150.000	-950.000
5	Shpenzimet	1.380.365	2.861.671	1.526.566
	- Interesi për kredinë në "BKT"	198.942	186.945	197.032
	- Shpenzime sipas INSTAT-it	785.714	785.715	785.715
	- Arredimi i shtëpisë që banon		1.200.000	
	- Arredimi i shtëpisë tjetër		310.770	
	- Për shkollimin e vajzës në shkollën jopublike "(***)"	138.709	136.274	133.917
	- Për udhëtime jashtë vendit	257.000	90.000	220.900
	- Shpenzime për kursin e gjuhës angleze		151.967	
	Diferenca	171.686	-72.779	32.688

– rezulton se subjekti ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për kryerjen e këtij investimi në bashkëpronësi.

Arsyetimi ligjor

Znj. F.D. merr statusin e personit të lidhur me subjektin e, për pasojë, mbart detyrimin për deklarim, në bazë të ligjit nr. 84/2016, udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së "Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Znj. F.D., pavarësisht se në deklaratën "Vetting" nuk ka deklaruar dy vlerat e tjera të blerjes së dy trojeve, përkatësisht 145.552 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.11.2008 dhe, 324.065 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 27.04.2011, ajo i ka deklaruar këto dy pasuri në Deklaratën Vetting së bashku me dy kontratat respektive me të dhëna të sakta identifikuese (numër repertori, numër koleksioni dhe datë përkatëse), të cilat kanë të përcaktuar si elemente të tyre edhe çmimin përkatës. Për rrjedhojë kemi të bëjmë me një magësi të karakterit material (mosshënimi i cmimit të blerjes)

dhe nuk mund të konkludohet se jemi përballë me një shkelje të ligjit që mund të çojë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.

Veç të tjerash, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2013 aktmarrëveshjen për bashkinvestim (*për rikonstruksionin*) dhe bashkëpronësi, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 28.01.2013, pikërisht në kohën kur ka lindur një marrëdhënie interesi me personin tjetër të lidhur, nënën e tij, znj. F. D.

Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme financiare në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës për kryerjen e bashkinvestimit sipas aktmarrëveshjes për bashkinvestim (*për rikonstruksionin*) dhe bashkëpronësi nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 28.01.2013, të deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti, bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, rezultojnë se pagesat për blerjen e objektit nga znj. F.D. janë kryer nga z. Sh. D., i cili i ka pasur mundësitë financiare për kryerjen e këtij shpenzimi. Ky fakt përforcohet po të marrim në konsideratë edhe të ardhurat e znj. F. D. në shumën 1.286.270 lekë për periudhën 2000 – 2011, sikurse rezultojnë nga vërtetimi i Degës së Sigurimeve Shoqërore Tropojë nr. (***) prot., datë 21.10.2016, si dhe nga përgjigjet në pyetësor të subjektit, ku ai deklaroi se këto shuma monetare janë të vogla dhe se mbuloreshin edhe nga kursimet e tij në vitet respektive.

Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, në vlerësimin tërësor të provave dhe deklarimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se, në kushtet që subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në vitin 2013 aktmarrëveshjen për bashkinvestim, si dhe burimin e krijimit të pasurisë dhe të bashkinvestimit në të, rezultojnë me të ardhura të ligjshme. Po ashtu, deklarimi në deklaratën “Vetting” i këtyre pasurive (godina, trualli nën objekt dhe trualli funksional), pavarësisht mungesës së pasqyrit të vlerës së dy trojeve, nuk kanë pasqyruar pasojë për fshehje pasurie dhe nuk të çojnë në lindjen e dyshimeve mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura.

4. Gjendje në llogari bankare, pranë “Credins Bank”⁷. Shuma: 972 000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Konfirmim bankar, nga “Credins Bank” për gjendjen e llogarisë së pagës.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka dërguar shkresën drejtuar 27 bankave, të cilat operojnë brenda territorit shqiptar dhe, me përgjigjen e ardhur, “Credins Bank” konfirmon këtë llogari në emër të subjektit.

Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”. Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

5. Gjendje në llogari bankare pranë “BKT”. Shuma 9.400 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi i kryer nga Komisioni

⁷ Shiko për më tepër shkresën me nr. (***) prot., datë 04.01.2018, drejtuar bankave dhe përgjigjet e ardhura me nr. (***) prot., datë 15.02.2018, me nr. (***) prot., datë 16.02.2018, nga “Credins Bank”, e cila e konfirmon këto llogari.

Nga korrespondenca e kryer me BKT-në, konfirmohet gjendja në llogarinë e kursimit në emër të subjektit të subjektit të rivlerësimit.

Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga "BKT"-ja . Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

6. Hetimi i kryer nga Komisioni për automjetet

- Komisioni ka kryer korrespondencë me DPSHTRR⁸-në në lidhje me automjete në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të, si dhe për automjete të cilat i ka përdorur subjekti.

Me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja rezulton një automjet në pronësi të vëllait të subjektit, Shkëlzen Dollapaj, me të cilin ka lëvizur subjekti. Gjithashtu, rezultojnë edhe 2 automjete në pronësi të N. D., motrës së subjektit, e cila sipas deklarimit të subjektit jeton në SHBA. DPSHTRR-ja nuk konfirmon automjete në pronësinë e subjektit dhe të personave të lidhur me të, të regjistruar në emrin e tyre.

Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja, se nuk ka automjete në pronësi.

Konstatime të tjera

- 7. Kredi e marrë në datën 18.05.2011 në "BKT" në vlerën 5.000.000 lekë, me afat 180 muaj, me interes 4 % në muaj. Këste mujore: 37.200 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në fillim të procesit të rivlerësimit është 3.504.087 (tre milionë e pesëqind e katërmijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nuk ka dyshime në lidhje me këtë kredi, shumën e shlyer dhe atë të mbetur pa paguar.

- 8. Likuidim i detyrimeve që burojnë nga kontrata me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 28.01.2013, për rikonstrukcionin e një shtëpie në fshatin Valbonë, ku nuk kanë përfunduar akoma punimet. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në fillim të procesit të rivlerësimit është 2.550.000 (dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nuk ka dyshime mbi këtë situatë financiare.

- 9. Verifikime mbi aktivitete fitimprurëse në emër të subjektit apo personave të lidhur me të.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

⁸ Shiko në dosje shkresën me nr(***)prot., datë 14.02.2018, dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***)prot., datë 26.02.2018, nga DPSHTRR-ja. Për më tepër shiko në dosje të Komisionit shkresën me nr. (***) prot., datë 19.03.2018, dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***)prot., datë 28.03.2018 nga DPSHTRR-ja.

Nga korrespondenca me QKB⁹-në konfirmohet se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë të pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizikë apo që zotërojnë kuota/aksione, në shoqëri tregtare, të regjistruara pranë regjistrit tregtar.

10. Deklarime të dhuratave në para *cash* në favor të subjektit të rivlerësimit

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, subjekti deklaron:

- Në Deklaratën Vjetore të Pasurisë (DVP) - 2006: 4.000 USD dhuratë *cash* nga motrat, V. T., N. S., V. D., D. N., gjatë vizitës së subjektit në Amerikë në dhjetor 2006 - janar 2007, për blerjen e një autoveture;
- Në DVP/2007: 3.000 USD, dhuratë *cash* nga motra D. N., në nëntor 2007;
- Në DVP/2009: 300 USD dërguar me “Western Union” nga kunati H.S.;
- Në DVP/ 2009: 500 USD, dërguar me “Western Union” nga N. R.;
- Në DVP/2013: 2000 USD, dërguar nga vajza e motrës, E. T., me “Money Gram”, datë 07.06.2013, nga Nju Jorku, SHBA;
- Në DVP/2013: 200 euro, nga vjehri im Q. G., me banim në Vlorë, me “AK-INVEST” datë 29.06.2013;
- Në DVP/2015: 500 USD, dërguar me “Money G” nga N. R., datë 01.07.2015.

Konstatohet se dy shuma, përkatësisht shuma prej 4.000 USD e deklaruar në DVP/2006 dhe shuma prej 3.000 USD, e deklaruar në DVP/2007, janë dhuruar *cash* nga motrat e subjektit dhe janë tërhequr po në *cash*, jashtë sistemit bankar nga ana e subjektit.

○ Në lidhje me dhuratën *cash* të shumës prej 4.000 USD është pyetur subjekti dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 datë.... ai sqaron se: *“Në periudhën 21 dhjetor 2006 deri në datën 17 janar 2007, unë kam qenë në një vizitë familjare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi atje jetojnë katër motrat e mia me familjet e tyre (V.T., V. D., N. S. dhe D. N.). Gjatë kësaj vizite më është dhuruar nga ana e tyre shuma prej 4.000 USD. Kjo shumë më është dhuruar cash për të blerë një autoveturë. Bashkëlidhur gjendet deklarata e motrës, V. D. (D.), që konfirmon me përgjegjësi këtë fakt dhe kontaktet e tri motrave të tjera”.*

○ Në lidhje me dhuratën *cash* të shumës prej 3.000 USD nga motra znj, D. D.(N.), subjekti në shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit sqaron se: *“Në muajin nëntor 2007 ka bërë një vizitë motra ime, D.D. (N.). Gjatë qëndrimit të saj, ajo më ka dhuruar sasinë prej 3.000 USD. Kjo sasi parash nuk më është dhënë për ndonjë qëllim të caktuar. Kjo dhuratë është deklaruar nga ana ime edhe në deklaratën periodike të vitit 2007. Bashkëlidhur deklarata”.*

Nga të dhënat e sistemit TIMS, konfirmohet se subjekti ka dalë nga territori i shtetit shqiptar më datë 21 dhjetor 2006 dhe ka hyrë më datë 17.01.2007.

Në dokumentacionin bashkëlidhur pyetësorëve 2 dhe 3, datë 11.07.2018, ndodhet dhe një deklaratë e shtetasës V. D. (D.), që konfirmon me vullnet të lirë dhe nën përgjegjësi ligjore se ajo dhe motrat e saj i kanë dhuruar vëllait të tyre shumën prej 4.000 USD cash, në dhjetor të vitit 2006, gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Deklarata, përveç nënshkrimit nga ana e deklaruesses, përmban edhe numrin e telefonit dhe adresën e saj në SHBA. Subjekti në pyetësor ka shënuar edhe numrat e kontaktit të motrave të tij.

Shuma e dhuruar në *cash*, prej 4.000 USD, konstatohet se është dhuruar nga të katër motrat e subjektit të cilat rezultojnë me një situatë të mirë financiare: a) znj. N.D., nga korrespondenca me DRSHTRR-në Tiranë (shkresa nr. (***)prot., datë 28.03.2018 rezulton të jetë pronare e një automjeti “BMW X5”, me targë (***), blerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2016

⁹ Shiko për më tepër shkresën me nr. (***)prot., datë 05.01.2018, drejtuar QKB-së dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***)prot., datë 16.01.2018.

për çmimin 27.800 USD dhe një automjeti të llojit “Mercedes-Benz”, me targë (***), blerë për shumën 5000 USD. Kjo shtetase dhe bashkëshorti i saj i kanë dhuruar dhe tri herë të tjera subjektit para nëpërmjet dërgesave si më sipër, çka dëshmon për një situatë të mirë financiare të tyre. b) Znj. D. D. i ka dhuruar përsëri subjektit shumën prej 3.000 USD në *cash*; c) mbesa e subjektit, E. T., vajza e motrës së subjektit, znj. V.T., i ka dhuruar 2.000 USD në vitin 2013.

Nga të dhënat e sistemit TIMS konfirmohet se shtetasja D. N., e datëlindjes 02.08.1964, me shtetësi amerikane (*pa të dhëna atësie dhe vendlindjeje*), ka hyrë në territorin e shtetit shqiptar në datën 01.12.2007 dhe ka dalë në datën 14.12.2007.

Në dokumentacionin shoqëruar të përcjellë nga subjekti bashkë me shpjegimet e dhëna nga ana e tij në lidhje me rezultatet e hetimit, ndodhet edhe një deklaratë personale e shtetasës D. N.D., me shtetësi amerikane, e cila deklaron se gjatë vizitës së saj në Shqipëri, në nëntor të vitit 2007, pranë nënës dhe vëllait të saj Arben, i ka dhuruar këtij të fundit shumën prej 3.000 USD, si kontribut për të dhe familjen e tij. Në deklaratë është shënuar edhe adresa e saj e banimit në SHBA.

Konkluzion

Duke marrë në konsideratë deklaratimet e shumave monetare *cash* nga ana e subjektit, përkatësisht në shumat dhe në vitet si më sipër, faktin se 5 prej tyre janë transferuar nëpërmjet institucioneve bankare, të dhënat e sistemit TIMS, marrëdhëniet shumë të ngushta familjare të dhuruesve dhe pranuesit të dhurimit (vëlla-motër-mbesë-vjehërr), deklaratat e personave dhurues, deklarin e këtyre shumave në deklaratat e pasurisë të viteve kur këto shuma janë dhuruar, - nuk ka indice apo edhe prova që ato të jenë produkt i ndonjë veprimtarie korruptive apo kriminale nga ana e subjektit.

Në përfundim, në vlerësimin e provave dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, nisur nga parimi i proporcionalitetit, si dhe bazuar në bindjen e brendshme, çmon se në kushtet që vlerat monetare të dhuruara janë kryer me transfertat bankare, nga institucionet bankare, një pjesë e tyre nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe rezulton se këto dhurata janë të deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike të pasurisë, dhe këto të fundit në bazë të nenit 32, pika 5, të ligjit 84/2016, mund të shërbejnë si provë, të krijojnë bindjen se të ardhurat e dhuruesve nuk janë në atë nivel, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara.

Rezultati përfundimtar në lidhje me vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me rivlerësimin e pasurisë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka pasaktësi në deklarin e pasurisë.
- ✓ Ka burime financiare të ligjshme dhe balancat financiare negative ndër vite, përkatësisht -36.013 lekë në vitin 2006 dhe - 72.779 lekë në vitin 2007 janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera në këto vite.
- ✓ Nuk ka kryer fshehje pasurie; nuk ka kryer deklarin të rremë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Bazuar në sa më lart, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa "a", të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raportin përkatës me nr. (***)prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi: "Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj". Ky raport është deklasifikuar¹⁰ më datë 30.01.2018.

Rezultati përfundimtar për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokuror.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet dhe pas një analize të plotë në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, me ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, duke rishikuar tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe me shkresën me nr. (***), datë 26.12.2017, ka përcjellë pranë Komisionit "Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale"¹¹ të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016.

- i) Raporti për analizën e aftësive profesionale të subjektit, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, u është referuar kriterëve të rivlerësimit, si:**
- a) Aftësitë profesionale;
 - b) Aftësitë organizative;
 - c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
 - ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;

¹⁰Vendimi nr. (***), datë 30.01.2018.

¹¹Shih për më tepër shkresën me nr. (***), datë 12.01.2018, ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ndodhet në dosje të Komisionit.

- 2) 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsytimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Qëndrimet e subjektit në përfaqësimin e organit të akuzës në proceset gjyqësore janë ligjore, të drejta në respektim të zbatimit të ligjit, duke ndikuar për zgjidhje përfundimtare të çështjes në përputhje me legjislacionin procedural penal.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Konstatohet mënyra e saktë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme si dhe përpilimi i kërkimit të prokurorit në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur për gjatë arsyetimeve.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, për periudhën e vlerësimit përreth dy vjet ka qenë në pozicionin e drejtorit në dy drejtori të Prokurorisë së Përgjithshme e për këtë arsye është spikatur dhe vlerësuar për aftësi shumë të mira drejtuese. Më konkretisht ka përgatitur strukturën organike e faktike të Prokurorisë së Përgjithshme dhe niveleve të tjera të prokurorive, ka organizuar mbledhjet e Këshillit të Prokurorisë sipas tematikave. Është marrë me drejtimin dhe organizimin e punës për inspektimet sipas urdhrave të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe verifikimeve sipas raporteve të kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, ai ka drejtuar punën për vlerësimin e punës së prokurorëve, sipas parashikimeve të rregullores përkatëse. Ka bërë planifikim të saktë të ndarjes së punës te prokurorët e stafit të Drejtorisë.

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se në këto vite ai është vlerësuar **“shumë mirë”** për aftësitë organizative të treguara prej tij, pasi ka përballuar ngarkesë pune të konsiderueshme sipas detyrave të përcaktuara, me cilësi dhe shpejtësi.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti nuk ka kryer procedura hetimore për periudhën e rivlerësimit, por mënyra sesi veprimet hetimore janë analizuar prej tij, për të mbështetur akuzën e ngritur fillimisht, është bërë gjithnjë në funksion të vërtetimit të kësaj akuze duke mbështetur akuzën e ngritur apo kërkimin e bërë nga prokuroria në shkallë të parë apo në apel, gjithmonë në mbështetje të zbatimit korrekt të ligjit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet proceduralë të përpiluara janë të sakta, të strukturuar në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i lartë me përgjegjshmëri, në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjekt të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka pasqyruar një komunikim e bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar, cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 6 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 6 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Subjekti ka shfaqur aftësi komunikuese mjaft të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, i komunikueshëm dhe duke shfaqur kompetencë profesionale në diskutime teknike, për çështje të ndryshme. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Subjekti ka cilësi shumë të mira bashkëpunuese. Ai ka qenë i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti rezultoi të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara, qoftë në rolin e pjesëmarrësit qoftë si lektor në Shkollën e Magjistraturës.

ii) Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore)

Referuar të dhënave arkivore pranë sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin subjekt vlerësimi, rezultoi se ***nuk ka të dhëna që kanë të bëjnë me ankesa dhe masa disiplinore të marra gjatë periudhës së vlerësimit.***

Pranë këtij sektori, ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, "Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve", si vijon:

Për vitet 2014, 2015, 2016, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, është vlerësuar "***shumë mirë***" për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi dhe shpejtësi.

iii) Përshkrimi i 5 dosjeve penale për prokurorin Arben Dollapaj, të përzgjedhura me short

Më datë 03.11.2017 në Prokurorinë e Përgjithshme, në prani të Grupit të Punës, prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u përzgjedhën me short 5 dosje. Kopje të këtyre 5 dosjeve në format letër janë përfshirë në dosjen e vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.

Nga 5 dosjet e përzgjedhura me short, rezultoi si më poshtë:

- Një dosje u vu në dispozicion nga Gjykata e Lartë;
- Një dosje u vu në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Një dosje u vu në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- Dy dosje u vunë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre 5 dosjeve:

- 1) **Mendim pa datë i muajit shtator 2015¹², «Në lidhje me çështjen penale nr. (***)2014 regjistri me kërkues: Prokuroria e Apelit Tiranë, i gjykuar H. Ç., akuzuar për veprën penale: "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/dh dhe 22 i Kodit Penal ».**

Nga aktet e administruara në lidhje me këtë çështje të shortuar rezultoi se: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. (***)2012, për veprat penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" mbetur në tentativë, dhe "Mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit" të parashikuar nga nenet 79/dh, dhe 22 dhe 278/2 të Kodit

¹² Akti nuk mban datë, por nga procesverbali i seancës rezultoi se është mbajtur më datë 16.09.2015

Penal, në ngarkim të shtetasit H.Ç.

Procedimi penal i mësipërm është regjistruar pas referimit të bërë nga Policia Gjyqësore. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin për gjykim të kësaj çështjeje penale në ngarkim të të pandehurit H.Ç., akuzuar për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, “Mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit” parashikuar nga nenet 79/dh dhe 22, 278/2 të Kodit Penal, si dhe të të pandehurit F.A., akuzuar për veprën penale “Moskallëzim i krimit” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. (***) , datë 30.07.2013, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit H. Ç.: a) për kryerjen e veprës penale “*Vrasja në kushtet e tronditjes së fortë psikike*” e mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal në lidhje me nenin 22 të po këtij kodi dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim; b) për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit F. A. për veprën penale “Moskallëzim i krimit” të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre muaj) burgim.

Mbi bazën e ankimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale për të pandehurin H. Ç. dhe masën e dënimit ndaj tij, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. (***) , datë 29.01.2014, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. (***) , datë 30.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Me rekursin e datës 13.02.2014 të prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë është kërkuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. (***) , datë 29.01.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. (***) , datë 30.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me cilësimin e veprës penale dhe masën e dënimit ndaj të pandehurit H. Ç.

Nga aktet e dosjes rezulton se prokurori Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, ka përfaqësuar akuzën në gjykimin në Gjykatë të Lartë, më datë 16.09.2015, duke dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë çështje penale.

Në mendimin e dhënë prej tij, prokurori Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, ka kërkuar të ndryshohet vendimi i Gjykatës së Apelit.

Mendimi është i strukturuar në tri pjesë: **pjesa hyrëse, arsyetuese-përshkruese dhe konkluduese.**

Në pjesën hyrëse të mendimit pasqyrohet pala kërkuese, i gjykuari, baza ligjore dhe gjykatën së cilës i drejtohet ky mendim.

Pjesa përshkruese-arsyetuese përbëhet nga tri nënpjesë:

Në nënpjesën e parë parashtrihen rrethanat e çështjes, faktet kriminale, objekti i hetimit, përshkruhen provat e fiksuara në vendngjarje e të sekuestruara në interes të procesit penal, personat që kanë dijeni për ngjarjen dhe rrethanat që dinë ato, procedurat e ndjekura nga Policia Gjyqësore apo Prokuroria, veprimet e kryera prej tyre. Nga aktet e dosjes **rezulton se**, më datë 21.05.2012, rreth orës 20:30, në lokalin “(***)” në pronësi të shtetasit S. Gj.ka shkuar si klient shtetasi E. B. Në lokal, në këtë kohë, ndodheshin shtetasit A. Gj. dhe J. Gj.(djemtë e shtetasit S. Gj.), të cilët ishin të punësuar aty dhe që, së bashku me shtetasit E. B., I. B. dhe

E. Xh., ishin ulur në një nga tavolinat në verandën e lokalit. Shtetasi E. B. është ulur në tavolinën ngjitur me tavolinën në të cilën ndodheshin shtetasit A. Gj. dhe shtetasit J. Gj. (të dëmtuar), E. B., I. B. dhe E. Xh. dhe ka porositur një birrë. Duke parë gjendjen e tij të dehur, i dëmtuari A. Gj. në fillim nuk ka dashur t'i shërbejë, por, më pas, duke parë këmbënguljen e tij, i ka shërbyer. Gjatë kohës që ishte duke pirë birrën shtetasi E.B. ka filluar një debat me fjalë me shtetasit E. B. dhe E. Xh. Duke parë debatin që po zhvillohej mes shtetasit E. B. dhe miqve të tij, shtetasi J. Gj. e ka nxjerrë shtetasin E. B. jashtë lokalit duke e shtyrë, pasi ai ishte i pirë dhe kundërshtonte, nuk donte të largohej. Për një moment shtetasi E. B. është rrëzuar. Në këtë kohë, i pandehuri H. Ç., i cili ndodhej në bilardon përballë me lokalin e vëllezërve Gj., duke parë që shtetasi J. Gj. kishte rrëzuar në tokë shtetasin E. B., i cili ishte mik me babanë e tij, ka ndërhyrë për të ndihmuar këtë të fundit dhe është konfliktuar me fjalë dhe pastaj me grushte me shtetasit J. Gj., A. Gj., E. B. dhe E. Xh.. Duke qenë se ata ishin më shumë në numër, i pandehuri H. Ç. është larguar duke thënë: “...do më njihni se kush jam unë...”. Pas konfliktit, i dëmtuari A. Gj. dhe shtetasit J. Gj., E.B., I. B. dhe E.Xh. janë rikthyer në tavolinën e tyre në verandën e lokalit “(***)”.

Pas rreth pesë minutash, i pandehuri H. Ç., është rikthyer në lokal duke mbajtur një armë zjarri, ai ka qëlluar një herë kur ka qenë rreth 10 - 20 m larg lokalit, më pas ka vazhduar të qëllojë duke iu afruar gjithmonë e më shumë verandës së lokalit. I pandehuri ka qëlluar katër herë në drejtim të lokalit ku ndodheshin i dëmtuari dhe shtetasit J. Gj., E.B., I.B. dhe E. Xh., duke shkaktuar dëmtime në rrethimin e jashtëm të verandës së lokalit dhe thyerjen e vetratës së tij, si dhe duke plagosur në këmbë të dëmtuarin A. Gj.

Për sa i përket të pandehurit F. A., ka rezultuar se ai ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, më datë 01.04.2012, rreth orës 20:00, kur, në një lokal pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 4, pas një zënke për motive të dobëta, ka qëlluar me armë zjarri shtetasin N.B. I pandehuri F. A., megjithëse ka qenë i pranishëm në lokal në momentin që shtetasi N.B. ka qëlluar me armë, është larguar nga vendi i ngjarjes dhe nuk ka kallëzuar faktin e ndodhur.

Në nënpjesën e dytë përshkruhen veprimet hetimore të kryera në fazën e hetimeve paraprake dhe faktet/konkluzionet që kanë rezultuar nga këto veprime, procedura gjyqësore, që përfshin vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, arsyetimin e saj për të arritur në atë vendimmarrje, shkaqet e ankimit të prokurorit të shkallës së parë, vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe arsyetimin e saj.

Në nënpjesën e tretë prokurori paraqet rekursin e prokurorit të apelit, shkaqet e tij, dhe se çfarë kërkon me rekursin e bërë.

Pjesa konkluduese e aktit përmban mendimin e prokurorit, subjekt rivlerësimi, në lidhje me zgjidhjen e çështjes nga ana e Gjykatës së Lartë, duke analizuar edhe një herë veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sjelljen e tij, mekanizimin e kryerjes së veprës penale dhe parashtrimin e kërimit të tij, konform nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale.

Konkretisht, nga ana e prokurorit Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, është kërkuar: « *Ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. 54, datë 29.01.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e deklaruar fajtor të pandehurin H. Ç. për kryerjen e veprës penale 'Vrasje në rrethana cilësuese' e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/dh dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 14 vite burgim, si dhe deklarimin fajtor të të pandehurit H. C., për kryerjen e veprës penale "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake" parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri H.C. të dënohet me një dënim të vetëm prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh burgim ».*

Akti që shfaq qëndrimin e prokurorit në gjykim nga përmbajtja rezulton se është i strukturuar me çështje, më konkretisht rrethanat e çështjes, procedurat gjyqësore dhe arsyetimet e gjykatave, rekursi, dhe konkluzionet e shfaqura në mendimin e tij. Fjalitë janë të qarta dhe të kuptueshme, akti përmban normat penale dhe procedurale penale, të aplikueshme në rastin

konkret, si dhe analizë të tyre ballafaquar me provat e grumbulluara gjatë hetimit dhe të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë (edhe pse prokurori ka kërkuar: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, duke e deklaruar fajtor H. Ç. për akuzën e parashikuar nga nenet 73/c dhe 22 të Kodit Penal), me vendimin nr. (***), datë 16.09.2015, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. (***), datë 29.01.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, për moszbatim të dispozitave materiale dhe procedurale penale.*

Nga aktet e kësaj çështjeje penale rezultoi se në rishqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, me vendimin nr. (***), datë 05.12.2016, të kësaj gjykate **është ndryshuar cilësimi** juridik i veprës penale **sikundër ka kërkuar edhe prokurori Arben Dollapaj** (subjekt rivlerësimi), në gjykimin në Gjykatë të Lartë, dhe H. Ç., i cili është deklaruar fajtor për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79/dh të Kodit Penal, dënuar me 10 vjet burgim, dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, dhe dënuar me 3 vjet burgim, e në bashkim të dënimeve është dënuar përfundimisht me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë dosje, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura procedurale hetimore.

Bazuar në nenin “E” të Aneksit të Kushtetutës, nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

- 2) Mendim, datë 30.09.2015, në lidhje me çështjen penale nr. (***), 2014 regjistri, me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, i gjykuar: A. A., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 të Kodit Penal, ndërsa M. K., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim krimi” parashikuar nga neni 300/1 të Kodit Penal.**

Rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. (***), të vitit 2011, për veprat penale të “Vjedhjes” dhe “Moskallëzimit të krimi”.

Procedimi penal i mësipërm është regjistruar pas referimit të bërë nga Policia Gjyqësore. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur dërgimin për gjykim të kësaj çështjeje penale në ngarkim të A. A., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, ndërsa M. K. akuzuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (***), datë 27.02.2012, ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit A. A., për veprën penale të “Vjedhjes” dhe në bazë të nenit 134/1 të Kodit Penal ta dënoje atë me **1 (një) vit burgim**. Në zbatim të nenit 406 të Kodit Procedurës Penale, ulet 1/3-ta e masës së dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin A. A. me **8 (tetë) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim për të pandehurin A. A., duke e vënë të pandehurin në provë për një afat 2 (dy)-vjeçar, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale. I pandehuri A. A. detyrohet të zbatohet nenin 60, pika 9, të Kodit Penal, “Të mos shoqërohet me persona të dënuar”.*

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit M. K. për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit” dhe në bazë të nenit 300 të Kodit Penal ta dënojë atë me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit Procedurës Penale, ulet 1/3 e masës së dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin M. K. me 2 (dy) muaj burgim.*

Mbi bazën e ankimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke mos e aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, **Gjykata e Apelit Durrës**, me vendimin nr. (***), datë 24.04.2014, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. (***), datë 27.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

Me rekursin e datës 16.05.2014 të prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, është kërkuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. (***), datë 27.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe i vendimit nr. (***) datë 24.04.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës në lidhje me aplikimin e gabuar të nenit 59 të Kodit Penal. Nga aktet e dosjes rezulton se prokurori Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, ka përfaqësuar akuzën në gjykimin në Gjykatë të Lartë, më datë 30.09.2015, duke dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë çështje penale.

Në mendimin e dhënë prej tij prokurori Arben Dollapaj, ka kërkuar të ndryshohet vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës dhe ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sa i përket aplikimit të nenit 59, pezullimin e dënimit me burgim për të gjykuarin A. A. Mendimi është i strukturuar në tre pjesë: pjesa hyrëse, arsyetuese - përshkruese dhe konkluduese.

Në **pjesën hyrëse** të mendimit pasqyrohet pala kërkuuese, i gjykuari, baza ligjore dhe gjykatën të cilës i drejtohet ky mendim.

Pjesa arsyetuese-përshkruese, përbëhet nga tri nënpjesë.

Në nënpjesën e parë parashtrohen rrethanat e çështjes, faktet kriminale objekt hetimi dhe një shkurtim i vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë për të pandehurit. Nga aktet e dosjes **rezulton se**, më datë 20.04.2011, shtetases H. I. në momentin që kalonte mbrapa bibliotekës së qytetit të Durrësit i është afruar një djalë i ri, i cili i ka tërhequr varësen e floririt nga qafa duke ia ka këputur e duke i marrë një qafore prej floriri. Nga hetimi i kësaj çështjeje është provuar se personi që ka kryer vjedhjen është i pandehuri A. A., i cili në komunikim me të pandehurin tjetër M. K., nëpërmjet bisedave telefonike ka pranuar faktin e vjedhjes së shtetases H. I., qëndrim ky i mbajtur gjatë gjykimin, duke konsumuar veprën penale të vjedhjes parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. I pandehuri M. K. nuk ka kallëzuar në organet kompetente për këtë ngjarje, si i tillë është proceduar për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Në nënpjesën e dytë përshkruhet procedura gjyqësore, që përfshin vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, arsyetimin e saj për të arritur në atë vendimmarrje, shkaqet e ankimit të prokurorit të shkallës së parë, vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe arsyetimin e saj.

Në nënpjesën e tretë prokurori paraqet rekursin e prokurorit të apelit, shkaqet e tij, dhe se çfarë kërkon me rekursin e bërë.

Pjesa konkluduese e aktit përmban mendimin e prokurorit subjekt rivlerësimi, z. Arben Dollapaj, në lidhje me zgjidhjen e çështjes nga ana e Gjykatës së Lartë duke kërkuar mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, referuar mekanizimit të kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë së autorit të veprës penale dhe parashtrimin e kërimit të tij, konform nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga ana e prokurorit Arben Dollapaj është kërkuar: *“Ndryshimi i vendimit nr. (***), datë 27.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ndryshimi i vendimit nr. (***), datë*

24.04.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës, për sa i përket zbatimit të nenit 59 të Kodit Penal dhe urdhërimit e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për të pandehurin A.A.”.

Akti që shfaq qëndrimin e prokurorit në gjykim nga përmbajtja rezulton se është i strukturuar me çështje të ndara në paragrafë, ku përfshihen rrethanat e çështjes, procedurat gjyqësore dhe arsyetimet e gjykatave, rekursi, dhe konkluzionet e shfaqura në mendimin e tij. Fjalitë janë të qarta dhe të kuptueshme, akti përmban normat penale dhe procedurale penale, të aplikueshme në rastin konkret, si dhe analizë të tyre ballafaqur me provat e grumbulluara gjatë hetimit dhe të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë (me vendimin nr. (***) , datë 28.10.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. (***) , datë 24.4.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës, për kualifikimin e veprave penale dhe dënimin e të gjykuarve. Ndryshimin e këtij vendimi lidhur me nenin 59 të Kodit Penal, duke hequr pezullimin e dënimit të këtij vendimi sipas këtij neni për të gjykuarin A. A.*

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer veprimet e duhura dhe të plota procedurale hetimore. Ky fakt vërtetohet edhe nga vendimmarrja përfundimtare e Gjykatës së Lartë.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paafësi profesionale të subjektit të rivlerësimit për rastin konkret.

3) Mendim datë 16.12.2015, në lidhje me çështjen penale nr. (*) , me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt: “Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit E. B.”.**

Nga aktet e administruara rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar procedimin penal nr. (***) , datë 10.07.2015, për veprat penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Ushtimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave”.

Me kërkesën e prokurorisë i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë vleftësimi i ligjshëm i ndalimit me iniciativë të personit nën hetim, E. B., dhe caktimi i masës së sigurimit *arrest në burg*, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për këtë shtetas.

Me vendimin nr. (***) , datë 16.07.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur: *Vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit me iniciativë të shtetasit E. B., person ky i dyshuar se ka kryer veprën penale “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.*

Mbi bazën e ankimit të personit nën hetim, E. B., në Gjykatën e Apelit Vlorë, është regjistruar çështja administrativo-penale me nr. (***) regjistri, e vitit 07.08.2015. Në ankimin e tij, shtetasi E. B. ka kërkuar mosmiratimin dhe ndryshimin e vendimit nr. (***) akti, datë 16.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, duke konstatuar vleftësimin e paligjshëm të ndalimit dhe lirim të menjëhershëm të personit nën hetim, E. B., nga dhomat e paraburgimit e masës së sigurimit nga ajo me arrest në burg me një masë më të butë.

Me vendimin nr. (***), datë 10.08.2015, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit të mësipërm për sa i përket masës së sigurimit, duke caktuar si masë sigurimi ndaj shtetasit E. B. "Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore" të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.*

Me rekursin e datës 07.09.2015, të prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, është kërkuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. (***), datë 10.08.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. (***), datë 16.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në ngarkim të të dyshuarit E. B., dhe të urdhërohet arrestimi i menjëhershëm i të dyshuarit E. B.

Mbi bazën e këtij rekursi, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. (***)2015, datë 05.10.2015, dhe prokurori Arben Dollapaj, ka shfaqur mendimin e tij në seancën e datës 16.12.2015.

Mendimi i paraqitur nga prokurori Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, është i strukturuar në tri pjesë, në pjesën hyrëse, në pjesën përshkruese - arsyetuese, dhe pjesën konkluduese.

Në pjesën hyrëse të mendimit pasqyrohet pala kërkuese, i gjykuari, baza ligjore dhe gjykata së cilës i drejtohet ky mendim.

Pjesa arsyetuese - përshkruese përbëhet nga tri nënpjesë:

Në nënpjesën e parë paraqiten rrethanat e faktit, faktet kriminale objekt hetimi dhe një shkurtim i vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për të pandehurit. Nga aktet e dosjes **rezulton se** shtetasi **E. B.**, me detyrë regjistruar pranë ZVRPP-së Lushnjë, dyshohej për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Regjistrimi i procedimit është bërë mbi bazën e kallëzimit të shtetasve A. P. dhe A. T. Sipas kallëzuesit, familja e tij ka në pronësi një truall në lagjen "(***)", në Lushnjë, dhe para 5 vjetësh shoqëria e ndërtimit "(***)", me pronare T. P., ka rënë dakord me babain e tij, K. P., për ndërtimin në këtë truall të një pallati ku ata do të përfitonin 23 % të ndërtimit. Ky ndërtim ka përfunduar dhe ai ka marrë në dorëzim apartamentet. Babai i tij, K. P., ka hasur vështirësi për regjistrimin e këtyre apartamenteve, pasi punonjësit e ZVRPP-së i kanë thënë verbalisht që pasuria krijonte mbivendosje me prona të tjera. Për këtë arsye, ai është drejtuar me shkresë dhe i kanë kthyer përgjigje që nuk krijohej mbivendosje. Sipas deklaruësit, edhe pas kësaj shkrese, prona nuk i është regjistruar. Në këto kushte, kallëzuesi A. P. është drejtuar pranë kësaj zyre dhe shtetasit M.Xh. dhe D. B. i kanë thënë që nëse donte të mbaronte punë shpejt, duhet të takonte shtetasin A. T. Gjithashtu edhe i dyshuari E. B. i ka thënë që të mbarosh punë, mund të drejtohesh te shtetasi A. T. Bashkë me vëllain e tij, shtetasin D. P., janë drejtuar te bar-restorant "(***)" në Lushnjë, ku kanë pyetur për shtetasin A.T. dhe pronari i lokalit u ka dhënë numrin e telefonit të A. Pasi kanë folur, kanë rënë dakord që të takohen. Pasi janë takuar, A. i ka kërkuar shumën prej 3.000 euro, në këmbim të dokumenteve, ku i ka shpjeguar se shuma prej 2.000 eurosh do ta mbante ai dhe shumën prej 1.000 eurosh do ia jepte drejtorit E. B.

Më datë 10.07.2015, kallëzuesi ka lidhur aktmarrëveshje me Policinë Gjyqësore dhe është autorizuar nga Policia Gjyqësore në kryerjen e veprimeve simuluese, konkretisht edhe për dhënien e parave. Sipas përgjimeve të komunikimeve telefonike, rezulton se kallëzuesi nuk ka arritur që të takohet me shtetasin A. T. pasi është larguar për në Itali dhe në këto kushte, aktmarrëveshjen me Policinë Gjyqësore e ka lidhur vëllai i tij, D. P.. Rezulton se ky i fundit ka marrë telefonatë nga shtetasi A. T. dhe ai i ka thënë që të lërë zarfin me shumën 3.000 euro te lokal "(***)",

dhe në këmbim ka marrë zarfin me certifikatat e pronësisë.

Në nënpjesën e dytë përshkruhen procedurat gjyqësore, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë me arsyetimin përkatës, ankimi i bërë nga pala në Gjykatën e Apelit Vlorë, disponimi i kësaj gjykate me arsyetimin e saj, duke qenë se në këtë gjykatë është bërë edhe ndryshimi i masës së sigurimit, rekursi i bërë nga prokuroria, shkaqet e tij, duke prezantuar edhe argumente për të kundërshtuar vendimin e gjykatës sa i përket ndryshimit të masës së sigurimit.

Në nënpjesën e tretë prokurori parashtron mendimin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke parashtruar në mënyrë analitike se cilat janë normat procedurale që duhet të vlerësohen nga gjykata në caktimin e masës së sigurimit, kushtet dhe kriteret që kërkon legjislacioni procedural penal, anën subjektive të të dyshuarit në raport me veprën dhe me provat.

Pjesa konkluduese e aktit përmban parashtrimin e kërtimeve të prokurorit, konform nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale. Konkretisht, nga ana e prokurorit Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, është kërkuar: *Prishja e vendimit nr. (***)*, datë 10.08.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe *lënien në fuqi të vendimit nr. (***)*, datë 16.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Vlorë. Gjykata e Lartë me vendimin nr. (***) , datë 16.12.2015, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. (***)*, datë 10.08.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe *lënien në fuqi të vendimit nr. (***)*, datë 16.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Vlorë.

Akti që shfaq qëndrimin e prokurorit në gjykim nga përmbajtja rezulton se është i strukturuar me paragrafë, me fjali të qarta dhe të kuptueshme, përmban normat penale dhe procedurale penale, analizë të detajuar të fakteve dhe provave.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura dhe të plota procedurale hetimore. Ky fakt vërtetohet edhe nga vendimmarrja përfundimtare e Gjykatës së Lartë.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

4) Konkluzione në çështjen penale, nr(*)/2016, më datë 29.06.2015, në ngarkim të të pandehurit A. H. akuzuar për veprën penale të “Vjedhje të energjisë elektrike apo impulseve telefonike” përpara Gjykatës së Apelit Shkodër.**

Nga aktet e dosjes së administruar për këtë çështje rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr. (***) , datë 28.11.2014, mbi bazën e referimit nga Policia Gjyqësore e Komisariatit të Policisë Lezhë. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur dërgimin për gjykim të kësaj çështjeje penale në ngarkim të A. H., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje të energjisë elektrike apo impulseve telefonike” parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin nr. (***) , datë 13.03.2015, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të pandehurit A.H. për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike” parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burg. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin A.H.me 4 muaj burg.*

Mbi bazën e ankimit të të pandehurit A.H., datë 25.03.2015, ku ai ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe caktimin ndaj tij të një mase më të butë dënimi dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, pra pezullimin e ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit me burgim duke e vënë në provë të pandehurin, çështja penale është regjistruar në

Gjykatën e Apelit Shkodër.

Me vendimin nr. (***) , datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër është vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. (***) datë 19.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me këtë ndryshim: 1.1.Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit A. H. për një afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh.*

Prokurori Arben Dollapaj ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër duke parashtruar qëndrimin e tij në konkluzionet e sipërcituara.

Konkluzionet janë të strukturuar në tre pjesë: pjesa hyrëse, përshkuese - arsyetuese dhe konkluduese.

Në **pjesën hyrëse** të konkluzioneve pasqyrohet kërkuesi/i gjykuari, akuza dhe baza ligjore, si dhe organi të cilit i drejtohen konkluzionet, si dhe gjykata që e ka dhënë vendimin dhe cilat kanë qenë disponimet e saj.

Pjesa përshkuese - arsyetuese përbëhet nga tri nënpjesë:

Në nënpjesën e parë parashtrohen rrethanat e çështjes dhe faktet kriminale objekt hetimi, nga të cilat rezulton se shtetasi A. H. ka lidhur kontratë me nr. (***) për furnizimin me energji elektrike me OSHEE-në. Nga verifikimi në sistemin që zotëron OSHEE-ja, rezulton se ky konsumator familjar nuk ka shlyer detyrimin kontraktor në vlerën 3.811.06 lekë. Më datë 03.11.2014, grupi i punës i OSHEE-së, pas verifikimit në sistem për mosshlyerje të detyrimit të konsumatorit, shtetasit A. H., ka shkuar në objektin e tij dhe e ka njoftuar atë që të shlyejë detyrimin, *duke e paralajmëruar se do t'i ndërpritej energjia elektrike*. Më datë 05.11.2014, grupi i punës i OSHEE-së ka bërë *ndërprerjen e energjisë elektrike për këtë konsumator*, pasi ka kaluar afati 48-orësh, brenda të cilit duhet të paguanin energjinë elektrike. Ky veprim është pasqyruar në procesverbalin përkatës. Më datë 25.11.2014, ky grup *ka konstatuar rilidhjen e energjisë elektrike, në kundërshtim me ligjin*, nga shtetasi A. H. Grupi i punës ka përpiluar procesverbalin e konstatimit të rilidhjes së energjisë elektrike.

Në nënpjesën e dytë janë të dhënat në lidhje me fillimin e procedimit penal, veprimet procedurale të kryera, administrimi i provave shkresore, analiza e provave me faktin penal dhe konkluzioni i arritur për marrjen e personit në përgjegjësi penale, duke paraqitur dispozitën përkatëse për të cilën akuzohet i pandehuri, A. H.

Në nënpjesën e tretë, prokurori arsyeton mbi dënimin që duhet të jepet nga gjykata, duke qenë se është pikërisht aplikimi i dënimit alternativ objekt i ankimit. Në këtë pjesë fillimisht prokurori paraqet parashikimin ligjor që gjykata duhet të mbajë parasysh në caktimin e dënimit penal, e më tej paraqet argumente se përse Gjykata e Apelit nuk duhet të pranojë ankimin e të pandehurit për aplikimin e dënimit alternativ. Gjithashtu, prokurori në këtë pjesë bën një analizë të individualizimit të dënimit, duke përmendur pjesë nga doktrina penale për këtë çështje, duke e krahasuar me çështje të tjera të ngjashme dhe citon pjesë nga praktika e Gjykatës Kushtetuese.

Pjesa konkluduese e aktit përmban parashtrimin e kërkimeve të prokurorit, konform nenit 428/1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Penale.

Konkretisht, nga ana e prokurorit Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, është kërkuar: *Lënia në fuqi e vendimit nr. (***) , datë 13.03.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.*

Akti që shfaq qëndrimin e prokurorit në gjykim nga përmbajtja rezulton se është i strukturuar me paragrafë, me fjali të qarta dhe të kuptueshme, përmban normat penale dhe procedurale penale, analizë të hollësishme të faktit penal me provat, referenca në praktika gjyqësore të gjykatës kushtetuese.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura dhe të plota procedurale hetimore. Ky fakt vërtetohet edhe nga vendimmarrja përfundimtare e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

5) **Konkluzione datë 06.10.2016 në lidhje me çështjen administrativo-penale me kërkues A. S., me objekt “Kthimin e sendit të sekuestruar”, çështja administrative me vendimin nr. (***) , datë 06.10.2016.**

Nga aktet e dosjes së administruar për këtë çështje rezulton se, në datën 07.03.2016, shtetas A. S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me kërkesë për kthimin e sendit të sekuestruar, një motor tip “Piaggio”, me ngjyrë gri, me targa (***) , i cili i ishte sekuestruar për llogari të procedimit penal nr. (***) të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, regjistruar më datë 13.11.2015, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal, me të dyshuar të pandehurin A.S. Regjistrimi i këtij procedimi penal është bërë në bazë të materialit të referuar nga shërbimi i policisë gjyqësore në Komisariatin e Policisë së Rrethit Lezhë, sipas të cilit rreth orës 8:10, të datës 12.11.2015, në qytetin Lezhë, përkatësisht në bulevardin “(***)”, në afërsi të kryqëzimit të Rr. “(***)”, shërbimi i Policisë Gjyqësore ka ndaluar motomjetin tip “Piaggio” me targë(***)dhe ka konstatuar se drejtohej prej shtetasit A. S. Gjatë këqyrjes së motomjetit, policia ka konstatuar se ky i fundit kishte të projektuar në kroskot një shpejtësi prej 80 km/h. Për rrjedhojë, policia i ka kërkuar kërkuesit A. S. lejen përkatëse të drejtimit të motomjetit, ndërsa ky i fundit është përgjigjur se nuk ishte i pajisur me leje drejtimi motomjeti të klasit “A”. Në këto rrethana pas hetimeve paraprake ky shtetas është marrë i pandehur për veprën penale “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, e parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal dhe në përfundim çështja i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Në përfundim të gjykimit ky shtetas është deklaruar fajtor dhe është dënuar për kryerjen e kësaj vepre penale. Ky vendimi penal ka marrë formë të prerë i pa ankimuar. Duke qenë se në këtë vendim gjykatë nuk është disponuar në lidhje me sendin e sekuestruar, kërkuesi A.S. ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesën me objekt si më lart cituar.

Me vendimin nr. (***) , datë 18.04.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur: *Mospranimi i kërkesës së kërkuesit, A. S.*

Mbi bazën e ankimit të bërë nga kërkuesi A. S., çështja administrative është regjistruar në Gjykatën e Apelit Shkodër me nr. (***)2016 dhe me vendimin nr. (***) , datë 06.10.2016, Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. (***) , datë 18.04.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Kthimin e mjetit motor tip “Piaggio” me ngjyrë gri me targa (***) .*

Prokurori Arben Dollapaj ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër duke parashtruar qëndrimin e tij në konkluzionet e sipërcituara.

Konkluzionet janë të strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe konkluduese.

Në **pjesën hyrëse** të konkluzioneve pasqyrohet kërkuesi, objekti dhe baza ligjore, organi të cilit i drejtohen konkluzionet, si dhe gjykata që e ka dhënë vendimin dhe cilat kanë qenë

disponimet e saj.

Pjesa përshkruese - arsyetuese përbëhet nga tri nënpjesë.

Në nënpjesën e parë parashtrihen rrethanat e çështjes, në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimit dhe gjykimit të procedimit penal për llogari të të cilit është marrë i pandehur kërkuesi A. S. dhe është dënuar.

Në nënpjesën e dytë janë të dhënat në lidhje me objektin e kërkesës për kthimin e sendit të sekuestruar, për të cilin është argumentuar se nuk ka pasur një disponim të organit procedues, qoftë prokuroria apo gjykata, në lidhje me motorin e sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

Në nënpjesën e tretë prokurori paraqet bazën e ligjore për disponimin e provave materiale, si dhe argumenton se përse gjykata në respektim të kësaj dispozite, duhet të verifikonte si organi kompetent se ku ndodhej sendi si dhe të dispononte në lidhje me të.

Akti që shfaq qëndrimin e prokurorit në gjykim, nga përmbajtja, rezulton se është i strukturuar me paragrafë, me fjali të qarta dhe të kuptueshme, përmban normat penale dhe procedurale penale, analizë të hollësishme të faktit penal, veprimeve procedurale të kryera e sendin si provë materiale, argumentet dhe provat mbi të cilat duhet të bazohet gjykata për të aplikuar dispozitat procedurale mbi disponimin e provës materiale.

Pjesa konkluduese e aktit përmban parashtrimin e kërkimeve të prokurorit, konform neneve, 424/1 dhe 428/1 germa “b” të Kodit të Procedurës Penale.

Konkretisht nga ana e prokurorit Arben Dollapaj, subjekt rivlerësimi, është kërkuar: *Ndryshimi i vendimit nr. (***)*, datë 18.04.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. *Pranimin e kërkesës së shtetasit A. S. për kthimin e sendit të sekuestruar.*

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura dhe të plota procedurale hetimore. Ky fakt vërtetohet edhe nga vendimmarrja përfundimtare e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

iv) Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues, si më poshtë:

1. Denoncim me nr. (*) prot., datë 26.12.2017.**

Denoncues: V.Ç., me adresë: “Rruga (***)”, nr. (***) , Tiranë.

Objekti i denoncimit: Korrupsion.

Denoncuesi, në ankesën e tij ngre pretendime se në vitin 1997 ka pasur tentativë për vrasjen e tij dhe për këtë i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë. Në denoncim ai kërkon: Të pyetet prokurori Arben Dollapaj se a ka dijeni për ankimet dhe kallëzimet e tij kur ishte drejtor inspektimi në Prokurorinë Përgjithshme dhe a ka mbështetur korrupsionin e vartësve të tij. *Unë, (vazhdon denoncuesi) kam marrë dy përgjigje nga ana e tij kur kam kallëzuar penalisht prokurorin E. K. dhe Arben Dollapaj ia kalon për kompetencë Prokurorisë së Tiranës, a mundet që një prokuror në Prokurorinë e Tiranës të hetohet për korrupsion dhe shpërdorim*

detyre brenda Prokurorisë së Tiranës? Gjithashtu edhe te ankesa e dytë e imja ky prokuror më kthen përgjigje së nuk është në kompetencën e Prokurorisë së Tiranës kallëzimi im.

Shtetasi V.Ç. ka paraqitur kërkesën e tij të bazuar në ligjin nr. 84/2016, por nuk ka bashkangjitur asnjë provë konkrete apo dokumentacion për të provuar pretendimet e tij, kërkesë kjo e ligjit përkatës.

Subjekti, në shpjegimet e tij të dërguara në lidhje me rezultatet e hetimit, sqaron si më poshtë:

“Në lidhje me letrën e shkruar nga ana e shtetasit V. Ç., ju konfirmoj se nga ana ime është bërë përpjekje për gjetjen e praktikës së këtij shtetasi pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 27.07.2018, por nuk është arritur të gjendet nga punonjësit e regjistrave përkatës.

Pavarësisht mungesës së referencës në dokumentacionin në lidhje me rastin konkret, unë po shpjegoj kuadrin ligjor dhe praktikën që është ndjekur në rastet e kallëzimit ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Në Kodin e Procedurës Penale parashikohet:

Kreu I, JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT, SEKSIONI II, me titull KOMPETENCA TOKËSORE, në neni 78, me emërtim “**Kompetenca për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve**”, parashikohet se:

1. Procedimet, në të cilat një gjyqtar ose prokuror **merr cilësinë e të pandehurit** ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, që sipas normave të këtij kreu do të ishin në kompetencën e një gjykate të rrethit, ku gjyqtari ose prokurori ushtron funksionet e tij ose i ushtronte në momentin e ngjarjes, janë në kompetencën e gjykatës që ka kompetencën lëndore dhe ndodhet në qendrën e një rrethi tjetër më të afërt, me përjashtim të rasteve kur në këtë rreth gjyqtari ose prokurori ka ardhur më pas për të ushtruar funksionet e tij. Në rastin e fundit është kompetente gjykata e një rrethi tjetër më të afërt me atë, në të cilën gjyqtari ose prokurori ushtronte funksionet e tij në momentin e kryerjes së veprës penale.

KREU II , SUBJEKTET E PROCEDIMIT PENAL, PROKURORI, në nenin 28 “**Kalimi i akteve një prokurorie tjetër**” parashikohet se:

1. Kur gjatë hetimeve paraprake **prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e një gjykate të ndryshme** nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente.
2. Prokurori që ka marrë aktet, në qoftë se çmon se duhet të procedojë prokuroria që ia ka dërguar aktet, **njofton Prokurorin e Përgjithshëm, i cili, pasi shqyrton aktet, cakton se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara.**
3. Veprimet hetimore të kryera para kalimit ose caktimit të bërë sipas paragrafit 1 dhe 2, janë të vlefshme dhe mund të përdoren në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të këtij kuadri procedural, në të gjitha rastet kur **kallëzimet** e bëra ndaj prokurorëve ose gjyqtarëve paraqiteshin në Prokurorinë e Përgjithshme nga ana e shtetasve ose institucioneve, Drejtoria e Hetimit ose Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, me një shkresë administrative ia dërgonte për kompetencë procedurale Prokurorisë së Shkallës së Parë, që mbulon territorin, ku pretendohet se ka ndodhur vepra penale.

Prokuroria përkatëse kryen verifikimet paraprake ose veprime procedurale dhe, në rastet kur konstaton kryerjen e veprës penale dhe duhet të **merret i pandehur** prokurori ose gjyqtari ndaj

të cilit është bërë kallëzimi, atëherë prokurori i çështjes, në zbatim të nenit 78 dhe nenit 28, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale, shpall moskompetencën, duke përcaktuar edhe prokurorinë se ku do të kalojë procedimi penal.

Prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka asnjë rol procedural në këtë fazë. Vetëm në rastet kur ka konflikt kompetence ndërmjet prokurorisë dërguese dhe asaj pritëse, atëherë ndërhyjnë prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme me vendim, duke zgjidhur konfliktin dhe duke përcaktuar prokurorinë që do të vazhdojë hetimet paraprake, më marrjen të pandehur të prokurorit apo gjyqtarit.

Në rastin konkret, mendoj dhe vlerësoj se ka një qëndrim të drejtë administrativo - procedural penal në dërgimin për kompetencë procedurale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të kallëzimit të bërë nga ana e shtetasit V. Ç.

Gjithashtu, konfirmoj se gjatë kohës që unë kam qenë në detyrën e drejtorit të inspektimit dhe burimeve njerëzore, ky qytetar është pritur dy herë nga ana ime dhe i janë sqaruar veprimet administrativo-procedurale, pasi ka pasur disa korrespondenca me Prokurorinë e Përgjithshme.”.

Nuk ka indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.

Në përfundim, në vlerësimin në tërësi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë”.

V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMI

1. Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj:
 - a) Ka pasaktësi në deklarime;
 - b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - e) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
2. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.
3. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI) dhe ligjit nr. 96/2016, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (neni 59, pika 1/a, i ligjit nr. 84/2016).
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59, pika 1/b, i ligjit nr. 84/2016).
- Ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 59, pika 1/c, i ligjit nr. 84/2016).

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 06.08.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Olsi KOMICI
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta

